

814-131

A 70

PAVOS ARADI

**DHJETOR
I SHQETESUAR**

ROMAN



3-31

+4

FATOS ABAPI

UJETOR I SHQETËSUAR

- ROMAN -

52562

LIBRARI E SHKOLLËS
SHKOLLËS NR 77



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»



Asnjë shkrepëtimë. Asnjë fëshfërimë ere. Vetëm e zeza, të palëvizura, varëshin grumbull dhe hnin shiun e tyre të imtë mbi qytet. Ai nderi rin «Nisemi...» i murmuriti Skodës. Maqina e duke marrë me vete zhurmën e hequrt, rrëshpëpara. Piklat e vogla të shiut spërkatnin xhamet e Shoferi nuk e hapi çelësin e fshesës. Në mbrëmje të qullur dhjetori, maqina fluturonte drejt Piklat shkriheshin njëra me tjetrën mbi xhame heshin bulëza, që rrëkëlleheshin pastaj e binin të. Udhëtarët e rrallë të asaj mbrëmjeje ecnin trove dhe ai, duke ngarë Skodën, shihte rrëkerat e mbi xhame.

Djali ishte mirë. Edhe gruaja mirë ishte. Kontakti nori me trupin e saj të ngrohtë e çlodhi dhe e oi. Thua sikur lodhja, që ishte mbledhur brenda vajti e u shkarkua edhe tek ajo. Dhe ai e ndjeu më të lehtë. Po prapë copëra të asaj lodhjeje kishin mbetur nëpër të. Thellë, diku, ai e ndjen- tëtë dhe, për t'u harruar, hidhte sytë mbi ato shiu, që binin e binin aty mbi xhame.

Para Skodës udhëtonin dy Zisa. Ishte lagjja e it dhe ata po dilnin nga qyteti. Tani dritat e llam- të rrugës ishin nderur dhe Kujtimi shihte mirë etë e ujërave, që derdheshin anëve të trotuarit.

Djali ishte mirë. Kur e kishte zbuluar, ai e kish foshnjën tek kishte hapur sa gjatë gjerë këmbët

topolake dhe duart. Dhe frymë merrte thellë. Prej asaj frymëmarrje ai e kishte kuptuar që foshnja ishte mirë. Dhe e kishte mbuluar.

Kurse gruaja ish mësuar me të. Kish tre vjet që ishte martuar. Në fillim ajo dëshpërohej. E priste. Kur humbiste çdo shpresë se i shoqi do të kthehej, qante. Dhe flinte shumë vonë. Tek i ati ajo ishte mësuar me shumë njerëz, kurse i shoqi s'kishte asnjëri. Ishte fillikat. Gruaja e pati vështirë, por u mësua. Tani që kish lindur edhe djalë, ajo thujse ishte qetësuar fare. «Grua shoferi je. Burrin sonte e ke në shtëpi, nesër s'e ke. S'ke ç'i bën...». Dhe ajo u mësua. Kur, sot, sapo u kthye, ai i tha: Erdha, po do të iki prapë. — Ajo s'bëri zë. U afrua dhe ata u përqaftuan me mall. Ai e kapi prej beli dhe e shtriu në kanape.

Pastaj ajo u ngrit shpejt e shpejt. Skuqi dy vezë dhe ai i gëlltiti në këmbë. Dhe u nis. Te dera e oborrut gruaja i tha:

— Vetëm 500 lekë më kanë mbetur.

— Edhe unë s'kam. Po e shumta dy ditë dhe do të kthehem — dhe, duke shkundur fort me të dy duart gëmushën e flokëve të zez, u nis.

E dinte që rruga ishte e gjatë dhe e lodhshme. Prandaj nuk e nxitonte Skodën. Edhe Zisat para tij ecnin shtruar. «Edhe ata në Dibër shkojnë? Po të jetë ashtu, udhëtojmë të tre...». Duke shtrirë trupin përpara, shoferi mbështeti mbi timon llërën e krahut të majtë dhe me dorën e djathtë nxori nga kamarja e kabinës paqetën «Dajti». E hapi ngadalë, mori cigaren dhe e vuri në buzë. Po nuk e ndezi. E dinte se, po ta pinte atë, prapë do të kërkonte të bënte diçka, përsëri do të ndizte një cigare tjetër. Ktheu kokën dhe shikoi nga dritarja e pasme. Tani nata kishte rënë. Bubulaku i dritave të qytetit gjithnjë e më tepër zvogëlohej. Në karrocerë dhogat e kardhonat qulleshin. Mushamanë ai e kishte vërtitur si lëmsh mbi to pa i mbuluar.

Njëri pas tjetrit Zisat u kthyen nga e majta. Kujtimi shtrëngoi timonin dhe Skoda vazhdoi të ecë gjithnjë drejt. Mejtimi se edhe ata dy kamiona, që udhëtonin para tij, mund të shkonin në Dibër, e kishte qetësuar disi. Kurse tani ai mbeti përsëri vetëm. Ndezi cigaren.

Ne shoferët shohim turli vendesh e turli njerëzish. Mund të na ndodhë gjithshka. Një mëngjezi, kur kthehesha nga M., jo shumë larg urës së lumit, pashë njerëz të mbledhur grumbull. Diçka jepnin e merrnin midis tyre. Sa iu afrova, ndala maqinën dhe zbrita. Një kapter policie, i ulur në tokë, mbante në duar një djalë të mbytur në gjak.

— Ç'është? — pyeta.

— E shtypi maqina...

— Vdiq.

—

— Po shoferi? — pyeta unë.

— Iku.

— Ohu!

Iu afrova kapterit. Preka ballin e djalit. I shkova dorën në zemër. Rrihte? Ashtu m'u duk.

— Po ky qenka i gjallë.

Kapteri më shikonte i shushatur.

— I gjallë, more, më kupton? Hapuni — thirra dhe fillova të shpërndaja kureshtarët, që ishin mbledhur te koka e djalit. E rrëmbeva në krahë. — Eja me mua — i gërthita kapterit dhe, duke vrapuar, ja hipa Skodës.

— Po si e shtypi? — e pyeta.

— Jo — tha ai, — duket se ky i ka hipur pas në karroceri. Dhe te ura është hedhur poshtë. Shoferi as që e ka parë.

Mbërritëm para infermerisë së vogël të lokalitetit. Kapteri i thirri infermieres. Kjo, duke rendur, doli jashtë. Kur pa ç'kishte ndodhur, u kthye, mori ç'i duheshin dhe hipi edhe vetë në maqinë. Kapteri zbriti.

Unë u nisa fugë për Tiranë. Gjatë rrugës pyesja infermierën:

— Rron?

— Rron...

Ja shkelja gjithë gazin. Kurrë s'e kam munduar Skodën si atë ditë.

— Rron?

— Rron...

Infermierja e kishte shtrirë djalin mbi ndenjësë dhe jepte e merrte mbi të.

— Ja edhe pak e arritëm.

Skoda gati sa s'hyri në dyert e spitalit. Rrëmbeva djalin dhe, duke rendur, hyra brenda. Të tjerë ma morën të plagosurin nga duart. Se ç'u bë më tutje s'di as vetë, sepse, pa dalë mirë nga dera e spitalit, më afrohet një polic.

— Ti je shoferi?

— Unë.

— Hajde me mua — më thotë me një zë urdhëronjës. — Ti ke shtypur një njeri...

— Unë?!

— Lëri llafet.

— More, po...

— Lëri llafet po të them.

Në polici më thanë se ishin lajmëruar që Skoda nr... kishte shtypur një njeri.

— Po, more, — u thashë. — E kanë gabim. Unë e ngrita me duart e mia djalin që ta sillja në spital.

— Po më parë e shtype.

— Kush jua tha? E kishin shtypur të tjerë. Pyesni kapterin, nga duart e tija e mora djalin.

— Do të pyesim — më thanë ata. — Ti rri aty.

Shfryja me vete; si ish ngatërruar puna papritur! M'u ça hunda për cigare.

— Nëm një — i thashë policit.

— Si i shtypni njerëzit kështu! — më tha gjithë inat, pa vënë dorën në kuti.

— S'e kam shtypur unë, oj dreq.

Më në fund kapteri i kishte sqaruar. Më liruan.
Po Skoda s'shihej gjëkund.

— Ku është maqina? — pyeta policin.

— Atje ku janë maqinat — më tha. — Nuk do të të priste ty...

— Oj dreq! — thashë. — Kanë marrë vesh shokët. Kush e di si është bërë gruaja... Hej, si u ngatërrroka njeriu...

«Një vend». Udhëtari, që qëndronte anës së rrugës, ngriti dorën nëpër shi. «Një», ja bëri ai prapë me gisht shoferit, duke i dalë përpara Skodës.

Maqina rrëshqiti e qëndroi te këmbët e tij. Udhëtari hapi derën dhe hyri në kabinë.

— Mbylle mirë — i tha shoferi.

Njeriu përplasi disa herë derën e hekurt, gjersa më në fund e mbylli. Skoda u nis përsëri. Udhëtari ishte bërë ujë. Rrëkezat i merrnin nëpër qylafin e zbërdhulur dhe i rridhnin poshtë në qafë e në gushë. Ai nxori nga xhepi një shamë të kuqe, të madhe dhe filloi të fshihej.

— Na kalbi ky shi — tha pastaj ngadalë.

— Për ku?

— Gjer këtu në Laç. — E bëri me dorë, sikur Laçi të shtrihej aty nën turinj të Skodës. Dhe nuk u ndie më. Shoferi i hodhi një shikim që nga koka e gjer te këmbët. Udhëtari ishte fshatar. Kishte veshur një xhakë të kadife të përdorur, një palë pantallona të leshta e këpucë me shollë të llastiktë. Si u fshi, u shtri më mirë në ndënjëse. Nxori nga xhepi kutinë e duhanit dhe me shikimin e ngulur gjithnjë drejt në rrugë, filloi ta dridhte.

— Na — i tha pastaj shoferit, duke ja vënë në buzë.

— Sapo e piva...

— Është i fortë.

Dhe filloi të dridhte edhe një për vetë. Shoferi u

mat t'i thoshte diçka, por heshti. Vetëm e shikoi me bisht të syrit. Kujtimit s'i pëlqente të udhëtonte i vetëm nëpër atë natë. Prandaj, kur njeriu anës së rrugës ngriti dorën nëpër shi, ai e ndali menjëherë maqinën. Të paktën të kishte me kë të këmbente një fjalë. Po fshatari qenkej i heshtur.

— Pse shkon në Laç?

Ai tjetri s'u përgjegj. Lagte me pështymë anëzat e letrës së duhanit. Dhe nuk përgjigjej. As shoferi s'e pyeti më. Ashtu kaluan një copë udhë. Fshatari ndezi cigaren e filloi ta hiqte thellë. Skoda fluturonte nëpër natë.

— Na zuri keq — tha më në fund fshatari.

Shoferi u këhye andej.

— Na zuri keq ky tërmet tani nëpër dimër — tha më tepër me vete fshatari, duke shikuar gjithnjë përpara.

— Po ti ku po shkon?

— Te ime bijë. Dhëndrri paska shkuar vullnetar në Dibër.

Fshatari sikur deshi ta ushqente më tej bisedën, po u përmbajt.

— Edhe ti për andej? — pyeti shoferin.

— Po.

— Tani të gjithë andej shkojnë.

Dhe ata përsëri heshtën.

Drejt tyre herë-herë vezullonin dritat e ndonjë maqine, që afrohej, kurse ndonjë tjetër me shpejtësi i arrinte e i kalonte nga pas. Të heshtur, ata shihnin pikëlat e shiut, që binin mbi xhame.

Kur i tha fshatari shoferit «Dhëndërri paska dalë vullnetar për në Dibër...», ai deshi të thoshte: «Më lajmëroi që të shkoj e t'i mbaj fëmijët...» po e la fjalën përgjysmë. Ai ishte gjysh, veç nipat nuk i njihte. Nuk i kishte parë asnjëherë. Këtu e 12 vjet të shkuara çupa ishte rrëmbyer me muratorin, që kishte vajtur në